



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizionit:

Universiteti „Shën Kliment Ohridski” në Manastir

Lënda e revizionit:



Revizioni raporteve financiare për vitin 2020, bashkë me revizionin e pajtueshmërisë të llogarisë së buxhetit themelor (603)

Qëllimi i revizionit:

Nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to janë në pajtim me rregullativën ligjore

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- në pajtim me statusin e ri të Universitetit nuk janë miratuar të gjitha aktet e brendshme, ndërsa në zbatim janë aktet e përgjithshme të miratuar me statusin e mëparshëm dhe deri në ditën e revizionit zbatohen akoma.

Mendimi i dhënë/përfundimi *:  

Shprehëm mendim pa rezervë për vërtetësinë dhe objektivitetin e raporteve financiare për vitin 2020, ndërsa, ndërsa mendim me rezervë për pajtueshmërinë e aktiviteteve, transaksioneve financiare dhe informacioneve me rregullativën ligjore, udhëzimeve dhe politikave të vendosur

Rekomandimet kyçe:

- të ndërmerren veprimtari në drejtim të miratimit të akteve të brendshme në pajtueshmëri me statusin dhe rregullativën ligjore.

Dobësitë kyçe të sistemit:

Formimi jo me kohë i organeve - Këshilli Kombëtar për Arsimin e Lartë dhe Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Agjencia për Cilësinë në Arsimin e Lartë me dy trupa kolektive: Bordi i Akreditimit dhe Bordi i Vlerësimit, më pas mos formimi i Këshillit të Universitetit, si dhe miratimi jo me kohë/ dhënien e pëlqimit të statuteve dhe akteve të tjera të përgjithshme të Universitetit

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Për Draft-Raportin e revizorit të autorizuar shtetëror nuk është marrë vërejtje, por nga Rektori i Universitetit „Shën Kliment Ohridski” në Manastir, është marrë letër për konfirmim/pëlqim për gjendjet e konstatuara nr. 14-163/14 prej 07.12.2021.

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

Përgjigja nuk është përgatitur për arsye se gjendjet e konstatuara u konfirmuan nga ana e Universitetit „Shën Kliment Ohridski” në Manastirë

*



pozitive,



me rezervë,



të pavolitshëm,



të përmbajtur